

UDHËZIM
Nr. 21, datë 14.6.2018

PËR ZHVILLIMIN E PROVIMEVE KOMBËTARE TË ARSIMIT BAZË 2018, SESIONI I DYTË

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenet 26, 27 dhe 50, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1013, datë 10.12.2010, “Për krijimin e Qendrës së Shërbimeve Arsimore”, të ndryshuar, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 67, datë 10.2.2010, “Për krijimin e Institutit të Zhvillimit të Arsimit”, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 352, datë 3.4.2013, “Për organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Shtetëror të Arsimit”,

UDHËZOJ:

1. Provimet kombëtare të arsimit bazë, sesioni i dytë, për vitin shkollor 2017–2018, do të zhvillohen si më poshtë:

- | | |
|-----------------|----------------|
| a) Gjuhë e huaj | 24 gusht 2018; |
| c) Gjuhë shqipe | 28 gusht 2018; |
| c) Matematikë | 31 gusht 2018. |

2. Nxënësit e pakicave kombëtare zhvillojnë edhe provimin kombëtar të arsimit bazë, sesioni i dytë, në lëndën Gjuhë amtare. Provimi kombëtar i arsimit bazë, sesioni i dytë, në lëndën Gjuhë amtare, do të zhvillohet më 22 gusht 2018.

3. Për provimet kombëtare të arsimit bazë 2018, sesioni i dytë, të ndiqen procedurat e përcaktuara në urdhrin nr. 88, datë 23.2.2018, “Për miratimin e rregullores për “Procedurat e organizimit dhe zhvillimit të provimeve kombëtare të arsimit bazë, viti shkollor 2017–2018””.

4. Provimet kombëtare të arsimit bazë 2018, sesioni i dytë, përcaktuar në pikat 1 dhe 2, të këtij udhëzimi, të fillojnë në orën 10:00 dhe të zgjasin 2 orë e 30 minuta.

5. Hartimi i testeve kryhet sipas rregullores për procesin e organizimit dhe zhvillimit të provimeve kombëtare të arsimit bazë 2018.

6. Për shkollat e pakicës kombëtare greke, teza për provimin në lëndën Gjuhë amtare, sesioni i dytë, përgatitet nga DAR Gjirokastrë. Zyra Arsimore Delvinë dhe Zyra Arsimore Sarandë, tërheqin në DAR Gjirokastrë tezën, ditën e provimit.

7. Për shkollat e pakicës kombëtare maqedonase, teza për provimin në lëndën Gjuhë amtare, sesioni i dytë, përgatitet nga DAR Korçë dhe tërhiqet ditën e provimit nga drejtori i shkollës, shoqëruar nga përfaqësuesi i DAR Korçë.

8. Nxënësit me aftësi të kufizuara zhvillojnë provimet kombëtare në përshtatje me veçoritë e tyre.

9. Arkivimi i testeve të bëhet pranë DAR/ZA-ve, në qendrat e vlerësimit të testeve.

10. Inspektorati Shtetëror i Arsimit monitoron procesin e provimeve kombëtare të arsimit bazë 2018, sesioni i dytë, dhe raporton për çdo parregullsi të vërejtur në zhvillimin e tyre.

11. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi zëvendësministri, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Inspektorati Shtetëror i Arsimit, drejtoritë arsimore rajonale, zyrat arsimore dhe institucionet shkollore.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT, SPORTIT
DHE RINISË
Lindita Nikolla